



KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
PRISHTINË - PRISHTINA

**KOLEGJI "PJETËR BUDI" – PRISHTINË**  
**PROGRAMI STUDIMOR – DOGANË DHE SHPEDICION**

# **TEMA BAÇELOR**

**LLOJET E TAKSAVE DOGANORE DHE NDIKIMI I TYRE**  
**NË ZHVILLIMIN EKONOMIK**

Mentori:  
Prof.Ass.Dr. Sabri Klaiqi

Kandidati:  
Olta Shala

**Prishtinë, 2025**

## ABSTRAKTI

Nëpërmes këtij punimi të diplomës po mundohemi të tregojm se qfarë lloje të taksave doganore kemi në Kosovë dhe cili është ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik në vend. Andaj, për qëllimin e lartpërmendur, ne do shërbejemi për veq literaturës shkencore profesionale, edhe me të dhëna studimore e hulumtuese nga institucione që mbulojnë këtë fushë, me theks të veçantë Dogana e Kosovës.

Ne me anë të këtij punimi, mëtojm të paraqesim rolin e tarifave doganore përgjithësisht dhe specifikisht të Doganës së Kosovës që kanë në buxhetin e shtetit, si institucion më meritor në këtë drejtim, ku Dogana e Kosovës përmes tarifave të saja tatimore dhe rregullatoreve të tjerë ekonomik arrin të grumbulloj apo kontribuoj për buxhetin e shtetit prej 50% deri në 70%.

Mbledhja, analizimi, trajtimi dhe përdorimi i duhur i informacionit janë elementet kyçe për një luftë të sukseshme kundër krimit ndërkufitarë, kontrabandës dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme që kërcënojnë tregtinë e ligjshme dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi.

**Fjalët kyçe:** *Politika fiskale, taksat doganore, sistemi fiskal, zhvillim ekonomik, masat politike zhvillimore, bashkimet doganore*

## FALËNDERIME

Duke qenë se puna e ime e deri tanishëme është fal mbështetjes dhe përkrahjes së vazhdueshme, fillimisht falënderoj familjen time për mbështetjen që më ka dhënë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi, sa të vështirë aq edhe të bukur që tashmë kulmoi me aktin final, punimin e temës së diplomes.

Një falënderim shkon për profesorin tim, mentorin Prof.Ass.Dr. Sabri Klaiqi, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi për gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e tij në finalizimin e punimit tim të diplomës, produkti i shumë orëve konsultimi dhe mbështetjeje nga ana e tij. Faleminderit Profesor!

# Tabela e përmbajtjes

<b>KAPITUULI I.....</b>	<b>7</b>
<b>1. Hyrje.....</b>	<b>7</b>
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>9</b>
<b>2. Shqyrtimi i Literaturës (Historiku) .....</b>	<b>9</b>
2.1. Doganat, zhvillimi i tyre dhe tarifat doganore .....	9
2.2. Plani Strategjik i Doganës së Kosovës (2024-2028).....	11
2.3. Qëllimi dhe vizioni i strategjisë .....	12
2.4. Si importohen mallrat në Kosovë .....	12
2.5. Normat mesatare të tarifave në import .....	12
2.6. Dokumentet e nevojshme për import dhe eksport.....	13
2.7. Mallrat e ndaluara ose të kufizuara për import.....	13
<b>KAPITULLI III.....</b>	<b>15</b>
<b>3. Taksat doganore në Kosovë .....</b>	<b>13</b>
3.1. Tatimi i normës së akcizës në Kosovë .....	14
3.2. Produktet e liruar nga akciza.....	16
3.3. Organizatat dhe subjektet që nuk paguajnë akcizë .....	16
3.4. Çka është TVSH-ja?.....	17
<b>KAPITULLI IV.....</b>	<b>18</b>
<b>4. Llojet e Doganave.....</b>	<b>18</b>
4.1. Ndarja sipas qëllimit .....	18
4.2. Ndarja sipas origjinës .....	19
4.3. Ndarja sipas mënyrës së doganimit .....	20
4.4. Ndarja sipas veprimit .....	21
<b>KAPITULLI VI.....</b>	<b>23</b>
<b>5. Efektet ekonomike të doganave .....</b>	<b>23</b>
5.1. Bashkimi i Doganave me ATK-në.....	24
5.2. Arsyetimi për bashkimin.....	24
5.3. Gjendja aktuale.....	25
<b>6. Përmbledhje .....</b>	<b>28</b>
<b>7. Konkluzione .....</b>	<b>28</b>
<b>8. Rekomandim final.....</b>	<b>29</b>
<b>9. Referencat.....</b>	<b>31</b>

# KAPITULLI I

## 1. Hyrje

Çështja e cila trajtohet në këtë punim ka të bëjë më atë se edhe pas shumë vitesh në Kosovë taksat doganore dhe efekti i tyre konsiderohen e një rëndesije të veçant për buxhetin e Republikës së Kosovës. Punimi trajton veprimet institucionale në përmbushjen e detyrave apo obligimeve që kanë të bëjnë me taksat doganore në Kosovë si dhe efekti i tyre në buxhetin e Shtetit.

Doganat në vendin tonë janë një instrument shumë i rëndësishëm i politikës fiskale në një anë, për shkak se me dogana mbidhet sasia më e madhe e mjeteve financiare, si dhe për shkak se doganat kanë pjesëmarrje të lartë në të hyrat e Përgjithshme buxhetore të Kosovës duke patur parasysh këtë, në këtë hulumtim do të trajtohen llojet e taksave doganore si dhe ndikimi dhe rëndësia e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.


Dogana e Kosovës vepron në pajtim me standardet e Bashkimi Evropian si organizatë doganore moderne në ngritjen e kapaciteteve administrative dhe teknologjike. Ngrit zhvillimin e saj drejt bashkëpunimit ndërinstitucional (Qeveria – Komuniteti i biznesit dhe Odat Ekonomike si dhe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar). Importi dhe eksporti i mallrave në Kosovë zhvillohen duke përdorur transporin rrugor (automobilistë dhe hekurudhor) dhe ajror.

**Kjo është rregulluar me ligj, udhëzim administrativ, përmes së cilit caktohen vendet e autorizuara për eksport dhe import të mallrave komerciale apo të ashtuquajtura “vendkalimet e autorizuara kufitare”. të cilat janë:**

- Hani i Elezit (edhe për qarkullim komercial)
- Gllloboçica
- Vërmica (edhe për qarkullim komercial)
- Qafa e Morinës
- Qafa e Prushit
- Porta 1 (Leposaviq) (edhe për qarkullim komercial)

- Merdare (porta 3) (edhe për qarkullim komercial)
- Kulla (edhe për qarkullim komercial)
- Porta - Delta 31 (Zubin Potok) (edhe për qarkullim komercial)
- Mutivodë (porta 4)
- Dheu i Bardhë (porta 5) (edhe për qarkullim komercial)
- Muçibaba (porta 6)
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (edhe për qarkullim komercial)

**Figura 1.** Harta me pikat e autorizuarra kufitare



**Burimi:** (<http://www.dogana.rks-gov.net>)

## KAPITULLI II

### 2. SHQYRTIMI I LITERATURES (HISTORIKU)

#### *2.1. Doganat dhe zhvillimi i tyre dhe tarifat Doganore*

Dogana e Kosovës është themeluar në gusht të vitit 1999 nga shtylla e BE-së, për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform të rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Me 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u shndërrua në Doganën e Kosovës. Kodi i ri doganor i miratuar me 11 nëntor 2008 nga Kuvendi i Kosovës, mundësoi këtë tranzicion. Kodi doganor në fjalë është në pajtim të plotë me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe ndër të tjera ka si objektiv edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Përpos detyrimeve doganore që vjelen nga Dogana, TVSH-ja dhe Taksa mbi akcizën vjelen nëpër kufij. Përveç vjeljes së të hyrave, Dogana e Kosoves e mbron shoqërinë nga kontrabandimi i drogës dhe mallrave tjera të ndaluara me efekt të dëmshëm të kimit ekonomik si dhe evazionit në të hyra.

Dogana Kosoves është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe është i financuar tërësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe aktualisht i ka rreth 591 punëtorë. Po ashtu është e përkrahur nga BE nëpërmjet menaxherëve të lartë profesionalë doganorë, si autoritet ekzekutues të huazuar nga Shërbimet Doganore të BE.

Dogana gjithashtu përfiton nga përkrahja teknike e Doganës së BE-së dhe nga Zyra për Asistencë Fiskale (CAFAO), e cila ka ndihmuar në zhvillimin e bazave të legjislacionit, organizimit, strukturës, në trajnimin dhe zhvillimin e stafit. Personeli i Shërbimit është i përbërë kryesisht nga nacionalitetet kosovare, prej tyre 20% janë minoritarë.

Dogana e Kosoves vjel rreth 70% e të hyrave të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës me një mesatare 2 cent për 1 euro në 2004. FMN ka lavdëruar vazhdimisht Shërbimin për performancën e tij, duke e krahasuar në një nivel me Shërbimet e Evropës Perëndimore.

Web-faqja e Doganës është themeluar në 2002 dhe është duke u zhvilluar në një mjet të rëndësishëm komunikimi në të mirën e tregtisë dhe publikut, duke dhënë më shumë detaje.<sup>1</sup>

Dogana e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Pra, misioni i Doganës së Kosovës mund të ndahet në dy kategori kryesore:

### **Kontributi në çështjet ekonomike**

- Mbledhja e taksave doganore: si, Taksa doganore, Tatimit mbi vlerën e shtuar; Akcizën për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.
- Kontrollimi importit dhe eksportit, mbrojtja e ekonomisë; mbrojtja e markave tregtare etj.
- Statistika të sakta mbi tregtinë me jashtë. **Kontributi për sigurinë**
- Luftimi i aktiviteteve ilegale
- Rritja e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare; luftimi i krimit kufitar; luftimi i trafikut të drogës etj.
- Mbrojtja e popullatës dhe ambientit, parandalimi kontrabandimit të armëve dhe substancave eksplozive.<sup>2</sup>

## ***2.2. Plani strategjik***

Strategjia e DK-së, është dokument i cili përcakton prioritetet dhe objektivat strategjike si dhe veprimet të cilat Dogana e Kosovës synon t'i ndjekë për periudhën 2024-2028.

Përmes kësaj strategjie, synohet përdorimi sa më racional i burimeve në dispozicion, zbatimi i politikave dhe zhvillimi i procedurave që lidhen me zinxhirin e tregtisë ndërkombëtare, qarkullimin e lirë të mjeteve dhe udhëtarëve, si dhe kontrollin doganor në kufi dhe në brendi të vendit.

Objektivat Strategjike të Doganës së Kosovës 2024-2028 janë në përputhshmëri të plotë me strategjinë dhe politikat zhvillimore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Tranferëve si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilave synohet modernizimi i mëtejshëm i administratës doganore, sistemi efikas i mbledhjes së të hyrave, lehtësimi i tregtisë legjitime, mbrojtja e shoqërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve.

Përmes kësaj strategjie, Dogana e Kosovës synon realizimin optimal të objektivave strategjike përmes zbërthimit në objektiva specifike dhe ndërmarrjes së aktiviteteve të nevojshme në të gjitha nivelet e

---

<sup>1</sup> <https://dogana.rks-gov.net>

<sup>2</sup> <https://dogana.rks-gov.net/Mission>

Doganës së Kosovës.<sup>3</sup>

Duke marrë në konsideratë rezultatet konkrete të arritura deri tani, DK vlerësohet si një nga institucionet me vlera të larta organizative dhe ndër kontribuesit kryesor në buxhetin e shtetit në aspektin e mbledhjes së të hyrave. Të hyrat e mbledhura nga DK përbëjnë rreth 50% e të hyrave të gjithëmbarshme që grumbullohen për Buxhetin e Republikës së Kosovës.<sup>4</sup>

### *2.3. Qëllimi dhe vizioni i strategjisë*

**Qëllimi** - Dogana e Kosovës synon përdorimin sa më racional të burimeve në dispozicion, zbatimin e politkave dhe zhvillimin e proceduarve që lidhen me zingjirin e tregtisë ndërkombëtare, qarkullimin e lirë të mjeteve dhe të udhëtarëve, si dhe kontrollin doganorë në kufi dhe në brendi.

**Vizioni** – DK e Kosovës do të vazhdojë me qasje pro-aktive në avancimin e kapaciteteve, duke operuar si e integruar dhe orientuar në rezultate e cila bazohet në sisteme të ndertuara, inteligjencë dhe menaxhim adekuat të rrezikut.

### *2.4. Si importohen mallrat*

Në momentin e importit të ndonjë malli atëherë varësisht nga procedurat të cilat e kërkon kompania importuese dhe bëhet zhdoganimi i tyre. Mallrat futen në pikën e kalimit kufitar dhe pastaj doganohen në terminale doganore (ZBD) për zhdoganimin e ngarkesave. Dogana e Kosovës lejon dy opsione të zgjedhje gjatë një importi, fillimisht kërkohet që të bëhet zhdoganimi në terminalin më të afërt nga pika e hyrjes. Si opsioni i dytë është terminali më i afërt me selin se ku është regjistruar kompania. Gjithashtu Dogana nuk bënë regjistrimin e bizneseve, kjo varet nga vetë kompanija se ku i regjistrojnë bizneset.

---

<sup>3</sup> <https://dogana.rks-gov.net/StrategicPlaning>

<sup>4</sup> <https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/Vendim-Shpjegues-Publik-Nr.3-2016-Vler%C3%ABsimet-dhe-Rivler%C3%ABsimet-Doganore.pdf>

## *2.5. Dokumentet e nevojshme per import dhe eksport te mallrave*

**Dokumentet te cilat janë te nevojshme për import dhe eksport te mallrave janë:**

- fatura në bazë të cilës deklarohet vlera doganore e mallrave;
- Deklarata për vlerat doganore te mallrave (DUD);
- Dokumentet për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore;
- Te gjitha dokumnetet e tjera të kerkuara për aplikimin e dispozitave që rregullojnë lirimimin për qarkullim të mallrave të deklaruar.

## *2.7. Mallrat të cilat nuk guxojnë të importohen në Kosovë ose importi i të cilave është i kufizuar*

**Janë disa ligje ne Kosovë të cilat, secilia nga fushë veprimtaria e vet i rregullon çështjet e mallrave të ndaluara dhe atyre të kufizuara të cilat janë:**

- Ligji nr. 04/L-197 i cili ndalon dhe kufizon importet e kemikateve ;<sup>5</sup>
- Ligji Nr.04/L-039 për kerkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konfirmitetit;<sup>6</sup>
- Ligji Nr.04/L-189 për sigurinë e pergjithshme të produkteve;<sup>7</sup>
- Ligji Nr.04/L-190 për produkte dhe paisje medicinale;<sup>8</sup>

**Sanksionimi i mallrave te ndaluara behet conform Kodit Doganor dhe te akcizave ku është paraparë që personi juridik apo fizik do të gjobiten me te holla në shumë prej 5.000€ deri ne 15.000€, nese:**

- Doganes nuk i paraqesin mallrat narkotike apo lënda për prodhimin dhe pëërpunimin e tyre.
- Doganes nuk i paraqesin armët, mjetet shperthyese dhe eksplozivet.
- Doganes nuk i'a paraqesin materialet e rrezikshme apo çdo mall i cili është i ndaluar për tu importuar ose eksportuar me legjislacionin, që është në fuqi në Kosovë.

---

<sup>5</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9370>

<sup>6</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2762>

<sup>7</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799>

<sup>8</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9437>

Secili mall që kalon ne pikat kufitare duhet te kaloj nepermes procedurave siq është kontrolla doganore.

**Për kontrollë doganore trnsaportuesi ose inportuesi i mallit është i obliguar të posedojë :<sup>9</sup>**

- Patentën e transportit ose fletëngarkimin
- Dëshminë për prejardhje të mallit
- Lajmërimin nderkombëtarë për doganim/ zhdoganim
- Leje për eksport dhe leje e shtetit importues

---

<sup>9</sup> Prof. Dr. Gordana Reçkoska “Njohja Doganore e Mallit”. Kolegji Pjeter Budi.

## KAPITULLI III

### 3. Taksat doganore në Kosovë

**Taksat të cilat paguhen me rastin e kalimit të kufirit të Kosovës janë:** <sup>10</sup>

- a) **Taksa doganore** e cila iu nënshtrohet mallrave me rastin e kalimit të kufirit dhe paguhet 10% në vlerë të mallit; Tarifa doganore është instrument i caktuar i politikës doganore të vendit e cila në atë menyrë e realizon mbrojtjen e ekonomisë vendit. Vetë tarifa doganore përbëhet nga masat dhe përqindjet që organi kompetent doganor i zbaton në doganimin e mallrave dhe qarkullimit doganor.<sup>11</sup>
- b) **Taksa e akcizës**, - e cila është një taksë e veçantë selektive që iu vihet një numri të caktuar të mallrave të tatueshme që lëshohen për konsum të lirë me qëllim të arritjes së efekteve të caktuara dhe paguhet në vlerë të mallit apo sipas njësisë matëse (specifike).
- c) **TVSH**, - e cila është një taksë e cila mblidhet në kufi nga Shërbimi Doganor në emër të administratës tatimore dhe paguhet 18% në vlerë të mallit.

Në teori dhe në praktikën financiare ekzistojnë mendime të ndryshme për arsyeshmërinë e ekzistimit të doganave. Ku e merr të drejtën shteti të caktojë taksa doganore për mallrat të cilat importohen, ekspozohen apo transitohen? Pse është e nevojshme të ekzistojë administrata doganore, e pyetje të tjera, të cilat qakullojnë në analet e studiuesve që merrën me këtë problematikë.

---

<sup>10</sup> <https://dogana.rks-gov.net/FAQ>

<sup>11</sup> Ligjerata te autorizuara "Proceduart administrative doganore" MA.PHD.CAN Sabri Klaiqi. Faqe 16

**Figura 2.** Forma vizuele e një Dokumenti Unik Doganor (DUD)

**DOKUMENTI UNIK DOGANOR**

Derguesi - Eksportuesi  
**ABC GBH**  
Gjermani, Hanover

HANI I ELEZIT - TERMINALI  
DUD nr. 1103  
Data: 10.01.2019

Marresi - Importuesi  
**Kosova Trade Sh.p.k.**  
KOSOVE

1 Sheqer 15,000 kg	Çmimi i mallit
	4,500.00 €
Shp.t.- 911.66 €	
2 Krip 8000 kg	Çmimi i mallit
	3,200.00 €
Shp.t.- 648.29 €	
3 Fishekzjarrë (2000 Pako = 50copa x 20gr) Gjithsej 2000 kg	Çmimi i mallit
	6,000.00 €
Shp.t.- 1,215.55 €	

Lloji	Baza per llogaritje	Shkalla e takses	Shuma
CD	5,411.66	10%	541.17
VT	5,952.83	18%	1,071.51
Gjithsej:			<b>1,612.67</b>

Lloji	Baza per llogaritje	Shkalla e takses	Shuma
CD	3,848.29	10%	384.83
VT	4,233.12	8%	338.65
Gjithsej:			<b>723.48</b>

Lloji	Baza per llogaritje	Shkalla e takses	Shuma
CD	7,215.55	10%	721.55
E	7,937.10	2 €	4,000.00
VT	11,937.10	18%	2,148.68
Gjithsej:			<b>6,870.23</b>

Lloji	Shuma
CD	1,647.55
E	4,000.00
VT	3,558.84
<b>9,206.39</b>	

**Burimi:** IKAF tekste studimi

### ***3.1. Tatimi i normës së akcizës në Kosovë***

**Akciza janë një tatim special, i veçantë, që aplikohen mbi disa produkte dhe grupe produktesh që plotësojnë kushtet e mëposhtme:**

- janë të dëmshme për shëndetin e njeriut,
- janë të dëmshme për mjedisin ku jetojmë,
- janë të dëmshme për shoqërinë
- kanë volum konsumi masiv.

**Këto grupe mallrash janë:**

- Duhani dhe nënproduktet e tij;
- Alkooli dhe pijet alkoolike;
- Nafta dhe nënproduktet e saj.

Mirëpo, në Kosovë akcizat nuk aplikohen vetëm mbi grup mallrat e mësipërme, por edhe mbi produkte të quajtura luksoze (telefona mobil, vetura, TV etj).

### ***3.2. Produktet e liruara nga akciza***

**Akciza nuk paguhet për:**

- a) Lëndën e pare dhe lëndën ndihmëse e cila përndryshe do të I nënshtrohej akcizës, të importuar në Kosovë nga personat e paisur me licencë të lëshuar nga Dogana e Kosovës, e cila e autorizon importin e tillë në rastin kur lënda e tillë do të përdoret për prodhimin e mallrave për eksport,
- b) Mallrat për të cilat Dogana e Kosovës përcakton se do shfrytëzohen vetëm për qëllime humanitare dhe se nuk do të ofrohen për shitjen a për konsumim në Kosovë dhe,
- c) Mallrat e financuara nga të hyrat e granteve të dhëna për Qeverinë e Republikës së Kosovës nga qeveritë, organizatat qeveritare dhe joqeveritare në përkrahje të programeve humanitare dhe të rindërtimit dhe të projekteve në Kosovë.

### *3.3. Organizatat dhe subjektet e tjera që nuk paguanë akzizë*

#### **Akciza nuk paguhet nga:**

- Misionet e huaja diplomatike dhe konsulare;
- Kombet e Bashkuara apo cilido organ I saj, duke përfshirë Eulexin, agjencite e specializuara te Kombeve te Bashkuara, KFORIN organizatat nderkombëtare ndërqeveritare dhe agjencite qeveritare përkitazi me mallrat e përdorura për qellime zyrtare;
- Kontraktoret e Eulexit, agjencite e specializuara te Kombeve te Bashkuara KFOR-it, të cilat importojë mallra që do të përdoren nga ata kontraktorë vetëm përkitazi me përmbushjen e kontratave per te lartëcekurit.
- Organizatat e regjistruara joqeveritare me status të beneficuar public për mallrat e përdorura vetëm nga organizatat joqeveritare në përmbushjen e qellimeve të statusit të saj të beneficuar.

#### **Këto mallra janë:**

- Benzina,
- Kerozina,
- Nafta dhe
- Etanoli.

### *3.4. Çka është TVSH-ja?*

TVSH-ja është tatimi mbi konsumin (qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve). Ky tatim mblidhet nga personat që janë regjistruar për këtë lloj tatimi dhe atë nepërmjet kryerjes së funksioneve të ndryshme që i bëjnë konsumatorit me të pare, duke përfshirë furnizimin e mallrave dhe shërbimeve. Çdo person i tillë në qarkullimin që kalon që kalon malli apo shërbimi nga burimi i furnizimit dhe deri tek konsumatori i fundit, vendoset një vlerë e shtuar e cila mblidhet nga shitësi për llogari të shtetit. Mund të themi se me rastin e mbledhjes së TVSH-së nga konsumatorët, biznesi luan një rol ndërmjetësues si urë lidhëse në mes shtetit dhe konsumatorit.

Konsumatori i fundit është ai që kryen qarkullimin final me shumën e vlerave të shtuara, furnizimit që ai ka blerë në çdo hap që ka kaluar furnizimi.

Në ditët e sotme TVSH-ja, mbetet forma më e favorshme e multiqarkullimit të përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve. Për të qenë e tillë TVSH-së i duhet të ketë një bazë të gjerë tatimpaguesish, me të ardhura të qëndrueshme. Ajo në strukturën e të ardhurave është një mekanizëm i thjeshtë i vlerësimit dhe mbledhjes së të ardhurave.

TVSH-ja është formë e tatimit me të cilën tatóhet vlera të cilën shitësi e ka shtuar në çmimin e shitblerjes së prodhimit dhe të shërbimeve, në secilën fazë të ciklit të qarkullimit. Baza e TVSH-së, është diferenca e ndërmjet çmimit furnizues dhe çmimit të shitjes. Pra Tatimi mbi Vlerë e Shtuar është tatimi mbi konsumatorin, të cilin në mënyrë indirekte e paguan konsumatori përmes bizneseve, të cilat në fakt kanë rolin e agjentëve ndërmjetësues.

TVSH-ja është një tatim që mblidhet me anë të metodës së vetë deklarimit. Personat e regjistruar dhe që paguajnë TVSH, deklarojnë në organet tatimore sasinë e TVSH-së që kanë për të paguar dhe janë organet tatimore që nepërmjet kontrollit verifikojnë nëse deklarimi ka qenë i saktë.

## KAPITULLI IV

### 4. Llojet e doganave

Me qëllim që të bëhet më efikas tregtia e jashtme, është bërë edhe ndarja e doganave. Ndarja e doganave “bëhet sipas kritereve, që zbatohen në vende të ndryshme e në kohë të ndryshme, si dhe nga aspekte të ndryshme”<sup>12</sup>.

**Sipas njohurive të deri tashme, ndarja e doganave zakonisht është bërë sipas këtyre kritereve kryesore, siç janë:**

- Sipas qëllimit,
- Sipas origjinës të mallrave,
- Sipas mënyrës së doganimit dhe
- Sipas mënyrës së veprimit.

---

<sup>12</sup> (Berisha, 1998, fq. 83).

## *4.1. Ndarja e Doganave sipas qëllimit*

**Sipas qëllimit doganat ndahen në:**

- **Dogana fiskale**

Në fillim me paraqitjen e doganave si instrument i politikës fiskale, ajo kishte karakter fiskal. Kjo me fjalë të tjera do të thotë se qëllimi kryesor i taksës doganore ishte arkëtimi i sa më shumë mjeteve financiare të shtetit. Karakteristikat e këtij lloji të doganës është së ka normë të ulët, në raport me taksat doganore mbrojtëse. Si mund ta dimë se taksa doganore ka karakter fiskal apo karakter mbrojtës. Kjo mund të konstatohet nga prejardhja gjeografike e mallit, pra duke u bazuar në kriterin se, a prodhohet malli ndaj të cilit aplikohet taksa doganore në vend apo jo. Andaj, “në rrethana kur malli për të cilin aplikohet taksa doganore nuk prodhohet në vend, atëherë taksa doganore ka karakter fiskal, sepse nuk i duhet mbrojtja nga konkurrenca ndërkombëtare”.<sup>13</sup> Ky lloj i taksave doganore paraqet burim shumë të rëndësishëm për krijimin e të hyrave buxhetore të shtetit përkatës.

- **Dogana ekonomike apo mbrojtëse**

Ky lloj i taksave doganore aktualisht është më i përhapur në botë. Thënë parimisht, të gjitha vendet e botës, pa marrë parasysh sistemin ekonomiko-shoqëror dhe nivelin e arritur të forcave prodhuese, e zbatojnë në njërin apo në formën tjetër, taksën doganore ekonomike-mbrojtëse. Me këtë lloj të taksës doganore, mbrohen bizneset dhe ekonomia vendore nga konkurrenca e jashtme. Sidomos, këtë taksë doganore e zbatojnë vendet me nivel të ulët të zhvillimit të forcave prodhuese. Qëllimi kryesor i taksës ekonomike, është që të zvogëlohet importi i mallrave nga vendet e tjera, dhe të krijohen parakushtet dhe kushtet për zhvillimin e ekonomisë vendore.

---

<sup>13</sup> (Rraci, 2010, fq. 95)

## *4.2. Ndarja e doganave sipas origjinës*

**Sipas origjinës (drejtimit) të mallrave, doganat ndahen në:**

- **Dogana importuese**

Të gjitha mallrat me origjinë nga vendet e tjera, të cilët e kalojnë vijën doganore të një vendi (shteti), ngarkohen me taksa doganore. Ky lloj i takse doganore, paraqet instrumentin më të rëndësishëm në tregtinë e jashtme të çdo vendi. Taksa doganore importuese, në rend të parë ka karakter të mbrojtjes së ekonomisë së vendit nga konkurrenca e jashtme. Ndonëse, në disa vende ky lloj i taksës doganore, zbatohet me qëllim të rritjes së të hyrave buxhetore të shtetit. Një karakter të përafërt me këtë e kishte edhe rritja e importit dhe zbatimi taksës doganore importuese, në të gjithë vendet është mbrojtëse, sepse me të rritë çmimin e mallit të importuar dhe ndikon në zvogëlimin e importimit të mallrave. Pos kësaj, roli dhe rëndësia e taksës doganore importuese, qëndron në faktin se nëpërmjet saj shteti mbron sovranitetin politik, territorial dhe ekonomik të tij.

- **Dogana eksportuese**

Ky lloj i doganave në jetën praktike zbatohet shumë rrallë. Taksa doganore eksportuese vihet atëherë kur malli që eksportohet ka rëndësi strategjike për ekonomin vendore. Me varjen e kësaj takse doganore, mbrohet tregu vendor dhe në këtë mënyrë ndalohet eksportimi i të mirave materiale që janë vitale për konsumatorin dhe ekonomin e vendit.

- **Dogana transite**

Taksa doganore transite, vihet për mallrat që kalojnë nëpër territorin e vendit, a destinacioni kanë vendin e tretë. Kjo taksë doganore në rend të parë ka 26 karakter fiskal por mund të përdoret edhe si masë për ndalimin e lirë të qarkullimit të mallrave. Në kohën bashkëkohore të ekonomizimit, veçmas me rritjen e proceseve integruese ekonomike ndërkombëtare nëpërmjet globalizimit, kjo taks doganore veç ka filluar të zbehet.

### *4.3. Ndarja e doganave sipas mënyrës së doganimit*

**Ndërkaq, sipas mënyrës së doganimit kemi këto lloje të doganave:**

- **Dogana sipas vlerës (ad valorem)**

Ky lloj takse doganore, aktualisht zbatohet në të gjitha sistemet bashkëkohore doganore. Taksa doganore sipas vlerës në rend të parë duhet kuptuar që ka karakter mbrojtës, që ka për qëllim mbrojtjen e prodhimeve vendore nga konkurrenca e jashtme. Ngarkesa e mallit me doganë sipas vlerës varësisht nga vlera që ka malli. Kështu, mallrat me vlerë më të vogël, ngarkohen shumë më të vogël takës doganore, në të kundërtën, mallrat me vlerë më të mëdha, ngarkohen me shumë më të madhe. Me këtë rast si problem në vete paraqet përcaktimin e vlerës së mallrave që janë për doganim. Taksa doganore sipas vlerës, zbatohet në mënyrë të barabartë dhe njësoj për të gjitha llojet e mallrave sipas vlerës së tyre.

- **Doganat specifike**

Ky lloj i taksave doganore në jetën praktike paraqet problem të ndërlikuar. Taksa doganore specifike llogaritet dhe arkëtohet për çdo lloj malli sipas njësisë matëse dhe çmimit veç e veç. Mangësia kryesore kësaj takse doganore është se ajo i ngarkon të gjitha mallrat njësoj, pavarësisht nga cilësia dhe vlera reale e tyre. Në jetën praktike mund të ndodhë që mallrat me vlerë më të madhe të ngarkohen me më pak detyrime doganore dhe, anasjelltas, mallrat me vlerë më të vogël të ngarkohen me më shumë detyrime doganore.

### *4.4. Ndarja e doganave sipas veprimit*

**Doganat sipas veprimit të tyre ndahen në:**

- **Dogana diferenciale**

Në dallim nga taksat doganore preferenciale taksat doganore diferenciale zbatohen sipas marrëdhënieve politike, të një vendi ndaj vendeve tjera. Andaj, ky lloj i taksave doganore me tepër ka karakter politikë, sesa ekonomik. Me këtë taks doganore favorizohen vendet më të cilat një vend ka marrëdhënie të mira pulitke dhe në të kundërtën vendet me të cilat nuk ka marrëdhënie diplomatike.

- **Doganat preferenciale**

Me këtë lloj takse doganore favorizohen, apo më mirë të themi privilegohen vendet me të cilat një vend ka marrëdhënie të mira politike. Ky favorizim bëhet duke aplikuar norma më të ulëta të taksës doganore nga ajo që është e përcaktuar me tarifatat doganore në fuqi. Andaj, doganat preferenciale janë ato dogana të cilat me rastin e doganimit të mallrave aplikohen norma më të ulëta, që ka për qëllim favorizimin e atij malli apo vendi, në raport me llojet e tjera të mallrave apo vendeve tjera. Në teorinë e financave publike, si dhe në jetën praktike, pos llojeve të sipër cekura të doganave hasim edhe në lloje të tjera të doganave. Na vazhdim të këtij punimi, do t'i përmendim vetëm disa prej tyre që mendojmë se janë më të rëndësishme.

- **Dogana ekonomike**

Këto dogana zbatohen me qëllim të mbrojtjes së ekonomisë së vendit nga konkurrenca e jashtme, për çka edhe shpesh quhen dogana mbrojtëse.

- **Dogana antidamping**

Me këto dogana ngarkohen mallrat e importuara me çmime të lira, me qëllim që të mbrohen prodhuesit vendor nga evazioni i mallrave nga jashtë të cilat shiten me çmime shumë të ulëta. Ky lloj i doganave në Kosovë ndoshta mund të zbatohet për mallrat që vijnë në tregun tonë nga Kina me çmime shumë të ulëta. Andaj, vendi për ta ruajtur çrregullimin e tregut të brendshëm që vjen nga këto dogana, për mallrat e tilla venë dogana plotësuese dhe të larta.

- **Doganat ndëshkuese**

Ky lloj i doganave zbatohet me rastin e shkeljes së dispozitave ekzistuese doganore. Me fjalë të tjera, ky lloj i doganave zbatohet vetëm atëherë kur importuesi apo eksportuesi i mallrave i shmanget obligimeve të parapara me ligjin doganor.

- **Dogana sociale**

Në qoftë se mallrat janë të dedikuara për shtresa sociale të popullsisë, për ndihma humanitare etj. zbatohen norma shumë të ulëta të doganave, me qëllim që çmimi kushtues i tyre të jetë sa më i ulët.

- **Dogana të përziera**

Me anën e këtyre doganave evitohen të metat e doganave ad valorem dhe të atyre specifike. Me fjalë të tjera, këto dogana paraqesin një lloj kombinimi mes doganave ad valorem dhe atyre specifike. Ky kombinim bëhet në atë mënyrë ku si bazë merret dogana ad valorem me kushte që lartësia sipas copës mos të jetë nën apo mbi një shumë të caktuar. Për shembull, “dogana ad valorem për një pikturë është 20% mirëpo jo më pak se 50 dollarë, apo jo më shumë se 100 dollarë për një copë”.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup> (Berisha, 1998 fq. 86)

## KAPITULLI V

### 5. Efektet ekonomike të doganave

Doganat, shikuar historikisht paraqesin instrumentin më të hershëm të politikës së tregtisë së jashtme, e cila ka shërbyere për rregullimin e transaksioneve ekonomike të një vendi me vendet e tjera. Kur kemi të bëjmë për efektet ekonomike të doganave, atëherë në rend të parë mendohet për doganat importuese, të cilat ndikojnë në zvogëlimin e importit, e nëse është në interes të ekonomisë kombëtare edhe ndërprerjen e plotë të tyre. Pra, si të tilla, këto dogana kanë karakter mbrojtës për ekonominë vendore. Andaj, “dogana mbrojtëse, paraqet pjesë të politikës së tregtisë së jashtme të vendit, qëllimi i së cilës është mbrojtja e prodhuesve vendor dhe shkallës së caktuar të punësimit nga konkurrenca e jashtme nëpërmjet doganave të veçanta”<sup>15</sup>.

Efektet ekonomike të doganës mund të jenë për ekonominë kombëtare në tërësi, si dhe për degë të ndryshme që mund të jenë të shumëfishta.

Analizat ekonomike në këtë fushë kanë treguar se, dogana nxitë zhvillimin e degëve prodhimet e të cilave mbrohen me doganë, në dëm të degëve që i shfrytëzojnë prodhimet e ngarkuara me doganë. Të shikojmë më për së afërmi efektet ekonomike të doganave në ekonominë e vendit. Të marrim një shembull ku importohet një mall i cili nuk prodhohet në vend, dhe një mall i cili pjesërisht prodhohet në vend. “Në rastin e parë, çmimi i mallit rritet për tërë shumën e doganës. Me këtë rast doganën e merr arka shtetërore, ndërsa e paguan konsumatori.

**Ndërkaq, në rastin e dytë, me rritjen e çmimit për shkak të zbatimit të doganës, dogana mund të ketë efekte të ndryshme**<sup>16</sup>.

- Së pari, tagrat doganore, sidomos, ato “mbrojtëse” ndikojnë në kufizimin e importeve;
- Së dyti, tagrat doganore mbrojtëse favorizojnë degët e industrisë së vendit relativisht jo eficientë, dhe i mbrojnë ato nga konkurrenca e huaj;

<sup>15</sup> (Ekonomski Leksikon, Krleža, 1995, fq. 81).

<sup>16</sup> (Hilmia, 1995, fq. 30)

- Së treti, kufizojnë dhe frenojnë specializimin, ndarjen ndërkombëtare të punës, e për rrjedhojë, kufizojnë shkëmbimet e lira në tregtinë ndërkombëtare;
- Së katërti, si tatime të tërthorta, tagrat doganore ndikojnë mbi nivelin e çmimeve të shitjes së mallrave, e për rrjedhojë, në kufizimin e konsumit dhe në zvogëlimin e pagës reale të punëtorit.

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha elementet ekonomike të doganave, mund të konstatohet se ato kanë karakter intervenuese nga ana e shtetit në rrjedhat ekonomike të ekonomisë kombëtare. Kështu, doganat si të tilla paraqesin instrument shumë të rëndësishëm, jo vetëm në politikën fiskale, por edhe në politikën e zbatuar ekonomike, e në veçanti në politikën e tregtisë së jashtme.

### *5.1. Bashkimi i doganave me ATK-n*

Shërbimi doganor (SHD) dhe administrata Tatimore e Kosovës (ATK) paraqesin dy institucione më të mëdha në vendin tonë që gjenerojnë të hyra më të mëdha buxhetore. Këto dy institucione kanë vepruar në mënyrë të pavarur njëra me tjetrën dhe kishin performancë të ndryshme, në kuptim se cila prej tyre grumbullonte të hyra buxhetore në Kosovë. Bashkimi i Doganës së Kosovës me Administratën Tatimore të Kosovës është një process institucional që ka qenë pjesë e diskutimeve të vazhdueshme për reformimin dhe modernizimin e administrates fiskale të Kosovës. Qellimi i këtij bashkimi është rritja e efikasitetit, ulja e kostove administrative dhe përmirësimi i mbledhjes së të hyrave buxhetore.

### *5.2. Arsyetimi për bashkimin e tyre*

**Arsyetimi për bashkimin e tyre synon që:**

- **Efikasitet me të madh në mbledhjen e të hyrave** – duke e pasur një adminoistratë të integruar, monitorimi i aktiveve ekonomike bëhet më i lehtë dhe më gjithëpërfshirës.
- **Shkëmbimi më i mire i informative** -duke bashkuar sistemet shmanget avzioni fiscal më lehtë.
- **Ulja e kostove administrative** – një adminitratë e përbashkët do të kërkonte më pakë burime se dy institucione të ndara.

- **Përmirësimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset** – duke krijuar një “one - stop – shop” për të gjitha obligimet fiskale.

**Kemi edhe shembuj ndërkombëtarë të bashkimit të Doganës me Tatimet.**

**Modele të ngjashme ekzistojnë në vende si:**

- **Suedia dhe Danimarka** – ku administratë doganore dhe tatimore janë të integruara.
- **Mbretëria e Bashkuar** – ku Doganat dhe Tatimet janë pjesë e një institucioni të vetëm.

**Gjatë procesit të bashkimit të këtyre dy institucioneve në një institucion të vetëm ka pas edhe sfida e disa prej tyre janë si vijojnë:**

- Kultura organizative të ndryshme mes Doganës dhe ATK-së,
- Strukturat teknologjike të ndryshme që kërkojnë integrim kompleks të sistemeve të IT,
- Riorganizim i stafit dhe rreziku për humbje të përkoshme të efikasitetit gjatë tranzicionit si dhe
- Ndryshimet ligjore që nevojiten për të krijuar një institucion të vetëm të integruar.

### ***5.3. Gjendja aktuale sipas të dhënave të fundit***

Qeveria e Kosovës ka propozuar më parë krijimin e një Administrate të përbashkët për të ardhura që do të përfshinte ATK-në dhe Doganën në një institucion të vetëm. Megjithatë, ky proces ka hasur në kundërshtim nga sindikatat dhe nga disa ekspertë, për shkak të shqetësimeve për transparencë, efektivitet dhe ndikim në punonjësit ekzistues.


Në vitin 2023 dhe 2024 janë zhvilluar disa studime fizibiliteti dhe janë bërë konsultime publike, por zbatimi i plotë i këtij bashkimi nuk ka ndodhur ende.

Në vitin 2024, Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), kanë arritur rezultate të rëndësishme në mbledhjen e të hyrave dhe në rritjen e transparencës fiskale. Po i rëndis më poshtë disa nga statistikat kyçe për vitin 2024 të shoqëruar me diagrame përkatëse.

### Dogana e Kosovës ka pasur një përmbledhje të aktivitetve kyçe si vijon më poshtë:

- Eksportet: në vitin 2024, Kosova ka eksportura mallra në vlerë prej 889 milion euro.
- Importet: Vlera e importve ka arritur në 6 miliardë e 38 milion euro.<sup>17</sup>
- Produktet kryesore të importuara: nafta dhe vajra, veturat dhe makinertë kanë dominura importet.

**Figura 4.** Shtetet nga te cilat Kosova Importon me shumti mallera



Burimi: <https://dogana.rks-gov.net>

<sup>17</sup> ekofin.al

**Figura 5.** Top 10 vendet që Kosova ka exportu më së shumti në vitin 2024



**Burimi:** <https://facebook.com/EurostatStatistics>

***Administrata Tatimore e Kosovës- Të Ardhurat dhe performance:***

- Të Ardhurat: ATK ka mbledhur 120 milion euro më shume se vitin e kaluar.
- Borxhi Tatimor: Borxhi i Përgjithshëm i papaguar ndaj Atk-së ka arritur në 533.6 milion euro.

**Me poshte mund te shihni te ardhurat buxhetore ne perqindje sipas llojit te tatimit në Kosovë gjatë vitit 2024.**

**Tabela 1.** Të ardhurat buxhetore totale për vitin 2024

Të ardhurat buxhetore totale (2024)	
Burimi	%
TVSH në import	40%
Akciza (naftë, duhan, etj)	20%
Tatimi në fitim	15%
Tatimi në fitim	12%
Të tjera	13%

**Burimi:** Fillimisht e punuar me excel pastaj e kam inkorporuar në punim.

TVSH në import dhe akcizat janë mbledhur nga Dogana - pra taksat doganore përbëjnë rreth 60% të totalit të të ardhurave tatimore indirekte.

## KAPITULLI VI

### 6. Përmbledhje / Përfundimi

**Taksat doganore janë një komponent kyç i politikë fiskale dhe tregtare të një shteti. Në rastin e Kosovës, ato luajnë një rol të shumfishtë:**

- Burim kryesor i të ardhurave shtetërore, duke financuar sektorë si arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura
- Mjet për mbrojtjen e prodhimit vendor, duke frenuar importet dhe duke i dhënë hapsirë zhvillimit të industrive locale.
- Instrument i politikave zhvillimore dhe rregullatore, që ndikon në strukturën e kosnumit dhe në orientimin e ekonomisë
- Mekanizëm për kontrollin e tregtisë ndërkombëtare, duke siguruar cilësinë e mallrave, mbrojtjen e konsumatorit dhe rregullin në treg.

#### *6.1. Konkluzionet*

**Taksat doganore janë themel për stabilitetin financiar të shtetit. Në Kosovë, mbi 50% e të hyrave tatimore vijnë nga Dogana- sidomos nga TVSH-ja në import dhe akciza.**

- Përdorimi strategjik i këtyre taksave mund të nxisë zhvillimin ekonomik vendor, por kërkon balance për të mos dëmtuar konsumatorët ose për të rritur koston e jetesës.
- Rritja e efikasitetit në mbledhjen e taksave doganore, bashkë me permirësimin e teknologjisë dhe transparencës, është thelbësore për luftën kundër kontrabandës dhe evazionit fiskal.
- Varësia e lartë nga të ardhurat doganore paraqet rrezik në planin afatgjatë, pasi ulja e importeve spo liberalizimi i tregtisë (si pjesë e integritit në BE), mund të ulë të ardhurat.
- Reforma në politikat doganore duhet të jetë e koordinuar me zhvillimin industrial dhe atë bujqësor, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e brendshme dhe të sigurohet zhvillimi ekonomik i qëndrueshem.

## 6.2. Rekomandimet finale

- Kosova duhet të ruaj bilancën midis mbledhjes së të ardhurave, mbrojtjes së interesave të konsumatorit dhe biznesit, dhe përgatitjes për integrim në tregjet ndërkombëtare. Kjo kërkon modernizim të vazhdueshëm të Doganës dhe harmonizim me standartet e BE-së.
- Buxheti i Kosovës është plotësisht i varur nga doganat pasi që pjesa dermuese e tij përbëhet nga të hyra doganore. Shtetet në zhvillim gjithmonë aplikojnë një politikë doganore pasi që fillimisht si të hyrë kryesore kanë doganat. Përqendrimi i buxhetit nga tatimi dhe taksat doganore një përqindje kaq të madhe , paraqet joqëndrueshmëri financiare, pasi niveli i importeve mund të ndryshojë, gjithashtu në bazë të disa marrëveshjeve ndërkombëtare, taksat doganore ose ulen ose eliminohen tërësisht, në këtë mënyrë reduktohen edhe të hyrat nga doganat të cilat ndikojnë në buxhetin e shtetit Doganat janë të hyra të cilat inkasohen në para të cilat i mbledhë shteti më rastin e kalimit të mallit të caktuar përtej kufirit shtetëror Doganat luajnë një rol shumë të madh për ekonominë e çdo vendi për arsye se doganat kanë si qëllim ruajtjen e ekonomisë.
- Roli i Doganave në grumbullimin e të hyrave buxhetore duhet të minimizohet nga viti në vit, ndërsa në Kosovë po ndodh e kundërta “p.sh në vendet europiane si Gjermani apo Austri roli kyq i Doganave është lufta kundër terrorizmit, krimit të organizuar e jo edhe grumbullimi i pjesës më të madhe të buxhetit.
- Qeveria e Kosovës duhet të nxitë politika fiskale të favorshme për nxitje të eksportit dhe prodhimit të brendshëm, e jo stimulimi i importit. Gjithsesi duke konsideruar se me kohë roli i doganës nuk do të jetë ashtu si deri më tani në mbushjen e buxhetit të Republikës së Kosovës (me rastin e implementimit të MSA-së dhe futjes në EU) atëherë shteti duhet të krijojë politika të cilat pjesëmarrjen në GDP të sektorit privat , duke i stimuluar ato më rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e vendeve të punës ku si pasojë e kësaj rritje do të kishte fuqi më të madhe blerëse dhe rrjedhimisht rritje të prodhimit.
- Bashkimi i Doganës së Kosovës me Administratën Tatimore do të krijojë një sistem të unifikuar të mbledhjes së të hyrave publike, do të rrisë efikasitetin funksional dhe do të përmirësojë përvojën e tatimpaguesve në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare.

- Unifikim dhe efikasitet operativ-aktualisht, janë dy agjenci që mirren me mbledhjen tatimore por kanë sisteme të ndara informatike, struktura të ndara dhe ndonjëhere procese të mbivendosura, kjo ndokon në rritjen e kostove administrative dhe në moskordinim. Bashkimi i Doganës së Kosovës me ATK-në, do të i eliminojë duplikimet, do të reduktojë burokracinë dhe do të krijojë një strukturë të vetme për menxhimin fiskal.
- Informacioni doganor dhe ai tatimor shpesh është komplementar. Bashkimi do të mundësojë shkëmbim të menjëhershëm të dhënave, analiza me të mira të rrezikut dhe kontrole me të efektshme të mashtrimeve me TVSH dhe kontrabankë. Shtet që kanë ndjekur këtë model (psh Suedia, Estonia, Kili) kanë parë rritje të ndjeshme në mbledhjen e të hyrave publike.
- Aktualisht bizneset kanë të bëjnë me dy institucione për çështje të ngjajshme fiskale . Me bashkimin kjo bëhet një **“one -stop-shop”** që kursen kohë dhe e rrit transparencën. Rritja e kapaciteteve analitike dhe teknologjike mund të bëhet përmes integrimin e sistemeve të IT, mund të krijohet një bazë e përbashkët e të dhënave, që forcon analizat fiskale dhe vendimmarrjen strategjike të shtetit në politikën tregtare.
- Ani pse janë dy funksione të ndryshme në natyrë (Dogana më shumë për kontrole të jashtme, ATK për kontrolle të brendshme), por të dyja funksionojnë si agjenci fiskale dhe kanë qëllim të përbashkët mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit. Prandaj bashkimi është organizimi më i mençur i funksioneve, jo përzirje e roleve dhe është në harmoni me rekomandimet e BE-së për integrim institucional të administratës fiskale, si pjesë e reformave për menxhimin e financave publike dhe përkatitjen për integrim evropian.

## Referencat

1. Tekst i përmbledhur nga burime të ndryshme dhe i përpunuar nga MA.PHD.CAN Sabri Klaiqi, Ligjerata të autorizuara, Kolegji Pjeter Budi “Procedurat Administrative Doganore”, Tetor Prishtinë, 2020.
2. Sisitemi doganor, Berisha, L, 1998.
3. Rraci Ylber, “Bazat e Sistemit Doganor”, Prishtinë, 2010.
4. Rraci Ylber, “Sistemi Doganor në Kosovë”, Prishtinë. 2003.
5. Kolegji “Pjetër Budi”, Ceku Orhan”, E Drejta Doganore”, Prishtinë, 2006.
6. Kolegji “Pjetër Budi”, Jovanka Biljanoska”, Sistemi Doganor”, 2006.
7. Berisha, 1998.
8. Ekonomski Leksikon, Krleza, 1995.
9. Hilmia, 1995.
10. Instituti për Kontabilitet Auditim Financa “Tatimet”.

## Burimet nga internet

1. <https://dogana.rks-gov.net>
2. <https://dogana.rks-gov.net/Mission>
3. <https://dogana.rks-gov.net/StrategicPlaning>
4. <https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/Vendim-Shpjegues-Publik-Nr.3-2016Vler%C3%ABsimet-dhe-Rivler%C3%ABsimet-Doganore.pdf>
5. <https://dogana.rks-gov.net/FAQ>
6. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2762>
7. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2799>
8. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9437>